

V E N D I M
Nr.507, datë 26.10.1993

PËR NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.207, DATË 4.5.1993
"PËR ÇMIMIN E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.207, datë 4.5.1993, pika 2 ndryshohet si vijon:
"Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për pordoruesit familjarë miratohen si vijon:

a) 0.8 lekë për çdo kilovat-orë për sasi të e përdorura në fakt brenda kufijve normativë të caktuara sipas zonave.

b) 3 lekë për çdo kilovat-orë për sasi të e përdorura në fakt mbi kufijtë normativë të caktuara sipas zonave".

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Çmimi i shitjes me pakicë i energjisë elektrike që përdoret nga përdoruesit e tjerë jofamiljarë, miratohet 2 lekë për çdo kilovat-orë".

3. Çmimi i shitjes me shumicë për përdoruesit jofamiljarë, për efekt të ndërtimit të marrëdhënieve me buxhetin e shtetit, miratohet 1 lekë për çdo kilovat-orë.

4. Ngarkohet Ministria e Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike të caktojë mënyrën e faturimit të energjisë elektrike për disa përdorues industrialë që kanë në administrim nënstacionet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi